



MISIONI I POSAÇËM PËR VLERËSIMIN E ZGJEDHJEVE I ODIHR-IT Republika e Maqedonisë së Veriut – Zgjedhjet e parakohshme parlamentare, 15 korrik 2020

DEKLARATË PËR GJETJET DHE PËRFUNDIMET PARAPRAKE

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 15 korrikut 2020 në përgjithësi u administruan në mënyrë efektive përkundër përshtatjeve si përgjigje ndaj pandemisë së KOVID-19, mirëpo stabiliteti ligjor u dëmtua nga rishikimet thelbësore të Kodit Zgjedhor dhe të rregulloreve pasuese *ad hoc* të miratuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Megjithëse me ton negativ, fushata zgjedhore ishte vërtetë konkurruese dhe pjesëmarrësit mund t'i përcillnin mesazhet e tyre përkundër kufizimeve në komunikimin tradicional. Mbulimi mediatik i zgjedhjeve kishte mungesë të vlerësimit kritik të platformave dhe dispozitave lidhur me reklamat e paguara politike të cilat i favorizuan tre partitë më të mëdha. Dita e zgjedhjeve kaloi pa probleme, përkundër sfidave teknike në publikimin e rezultateve dhe shqetësimeve në lidhje me regjistrimin e votuesve.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare fillimisht u caktuan më 12 prill 2020.¹ Për shkak të përhapjes globale të KOVID-19, më 18 mars Presidenti shpalli gjendje të jashtëzakonshme 30 ditore, ndërsa më 21 mars zgjedhjet u pezulluan me një dekret qeveritar, i cili parashikonte që procesi zgjedhor do të rifillonte nga dita e heqjes së gjendjes së jashtëzakonshme. Gjendja e jashtëzakonshme u vazhduar katër herë, ndërsa herën e fundit për vetëm tetë ditë me qëllim të ricaktimit të zgjedhjeve.² Paraprakisht, në janar të vitit 2020 u krijua një qeveri teknike e përbërë nga përfaqësues të partive qeveritare dhe opozitare, pas dorëheqjes së kryeministrit, në pritje të zgjedhjeve të parakohshme dhe asaj iu dhanë kompetenca të jashtëzakonshme ligjore. Një numër i madh kundërshtimesh u parashtruan në Gjykatën Kushtetuese lidhur me legjitimitetin e vendimeve presidenciale për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme pa miratim të parlamentit dhe për kompetencat ligjore që i janë dhënë qeverisë. Data përfundimtare e zgjedhjeve të 15 korrikut u përcaktua pas negociatave të gjata midis partive politike në lidhje me nevojën për të rikrijuar një qeveri dhe parlament të përhershëm dhe për masat e sigurisë për mbajtjen e zgjedhjeve gjatë periudhës së pandemisë.

Zgjedhjet u zhvilluan në bazë të kornizës ligjore, e cila u ndryshua thelbësisht në prag të shpalljes së zgjedhjeve, në kundërshtim me praktikën e mira ndërkombëtare.³ Ndryshimet e futura në Kodin Zgjedhor në shkurt të vitit 2020 trajtuan pjesërisht disa rekomandime të ODIHR-it për çështje si regjistrimi i votuesve, transparenca e zgjidhjes së kontesteve zgjedhore, afatet për dorëzimin e raporteve për financimin e fushatës dhe mbikëqyrja e fushatës.⁴ Megjithatë, shumica e rekomandimeve të ODIHR-it mbeten të patrajuara, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me universalitetin dhe barazinë e votës në njësinë zgjedhore jashtë vendit, rishikimin e kufijve të njësisve zgjedhore nga një organ i pavarur, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara si dhe kontrollin efektiv të financimit të

¹ Mocioni për të shpallur zgjedhje të parakohshme parlamentare u nxit nga vendimi i Këshillit të Evropës në tetor 2019 për të mos hapur negociata për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian (BE), i cili u vlerësua gjerësisht si një zhgënjim i rëndë për partinë në pushtet dhe e nxitu qeverinë të jepë dorëheqje. Më 16 shkurt, Kryetari i parlamentit e shpërbëu parlamentin dhe shpalli zgjedhje të parakohshme.

² Kushtetuta lejon shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme vetëm në rast të fatkeqësive të mëdha natyrore ose epidemive. Për më tepër, vendimi i 15 qershorit u miratua dy ditë pas skadimit të vendimit të mëparshëm, që, megjithatë, nuk çoi në zhvillimin e ndonjë aktiviteti lidhur me zgjedhjet, në kundërshtim me dekretin e detyrueshëm qeveritar të 21 marsit.

³ Paragrafi II.2.b. i [Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore të Komisionit të Venedikut të vitit 2002](#) dhe paragrafi II.58 i Raportit të tij shpjegues.

⁴ Shih [raportet e mëparshme të ODIHR-it për zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut](#), duke përfshirë raportin e përkohshëm të prillit 2020.

fushatës. Mospërputhjet e vazhdueshme, zbrazëtitat dhe formulimet e paqarta dëmtojnë qartësinë ligjore dhe kërkojnë rishikim thelbësor të mëtutjeshëm.⁵

Përkundër interpretimit gjyqësor se kompetencat legislative të qeverisë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme duhet të përshtaten me nevojat e jashtëzakonshme, dekretet e detyrueshme qeveritare përfshinin një pjesë të madhe të jetës publike, duke përfshirë edhe procedurat zgjedhore, të cilat, në bazë të Kodit Zgjedhor, janë në kompetencë të institucioneve të tjera, duke i zëvendësuar vendimet e tyre.⁶ Dekretet rregullonin rifillimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor, vlefshmërinë e procedurave të përfunduara më parë, regjistrimin e votuesve, zhvillimin e fushatës në media, si dhe përcaktuan standarde dhe procedura për respektimin e protokolleve shëndetësore, duke përfshirë edhe një ditë shtesë votimi për votuesit që janë pozitiv ndaj KOVID-19 dhe të atyre që janë në vetizolim. Rregulloret qeveritare për ngjarjet në hapësira të mbyllura dhe të hapura kishin mungesë konsekuente dhe konsolidimi, duke dëmtuar qartësinë ligjore dhe zbatimin. Në përgjithësi, miratimi i vazhdueshëm i ndryshimeve të dekretëve e dëmtoi kuptimin e përgjithshëm të esencës dhe vlefshmërisë së tyre.⁷

Zgjedhjet u administruan nga një strukturë me tre nivele, e udhëhequr nga ana e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), i cili mbështetet nga sekretariati profesional. Administrata zgjedhore i kreu detyrat e saj brenda afateve ligjore, përkundër ndërlikimeve të shkaktuara nga pezullimi i procesit zgjedhor dhe shqetësimeve të paraqitura publikisht nga KSHZ-ja gjatë gjendjes së jashtëzakonshme në lidhje me kalendarin zgjedhor. KSHZ-ja i miratoi vendimet në mënyrë kolegjiale, shpesh me debate thelbësore, në mbledhje të cilat ishin të hapura për vëzhguesit dhe që transmetoheshin drejtpërdrejt në ueb-faqen e Agjencisë shtetërore të lajmeve të Maqedonisë (MIA) si dhe në faqen e Facebook-ut të KSHZ-së. Shumica e mbledhjeve të KSHZ-së u lajmëruan pak para se të mbahen ato, por vendimet dhe procesverbalet u shpallën në ueb-faqen KSHZ-së në kohë, duke kontribuar në transparencën e përgjithshme të procesit. Mirëpo, vendimet mbi kundërshtimet nuk u publikuan në mënyrë konsekuente dhe aplikacioni onlajn për kundërshtime nuk ishte funksional gjatë gjithë procesit zgjedhor, përkundër rekomandimeve të mëparshme ODIHR-it për ta trajtuar këtë çështje. Personeli i pamjaftueshëm i përhershëm juridik dhe i TIK-ut e zvogëloi kapacitetin e përgjithshëm operativ të KSHZ-së, përkundër rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it.

Bashkëbiseduesit e MPVZ të ODIHR-it në përgjithësi shprehën kënaqësi me efektivitetin e KSHZ-së, megjithëse disa e vunë në dyshim strukturën partiake të Komisionit. Për shkak të pezullimit të aktiviteteve zgjedhore, KSHZ-ja funksionoi me mandat të zgjatur me dekret të qeverisë deri në gjashtë muaj nga mbajtja e zgjedhjeve. KSHZ-ja përbëhet nga shtatë anëtarë (duke përfshirë tre gra) të emëruara nga partitë politike parlamentare (katër nga partitë në pushtet dhe tre nga opozita). Para përcaktimit të datës së zgjedhjeve, anëtarët e KSHZ-së u ndanë në vija të forta partiake në lidhje me bazën ligjore për

⁵ Rregulloret jokonsekuente përfshijnë normat për mirëmbajtjen dhe modifikimin e regjistrimit të votuesve, përpilimin e listave të votuesve, regjistrimin e votuesve në njësinë zgjedhore jashtë vendit, afatet e paharmonizuara për regjistrimin e votuesve dhe të kandidatëve, zhvillimin e fushatës dhe afatet e fushatës, përcaktimin e çmimeve për reklamat politike dhe shpërndarjen e kuotave për reklamat politike midis pjesëmarrësve në fushatë, shpërndarjen e kompensimit nga buxheti për shpenzimet e fushatës, raportimin e kontributeve në natyrë për qëllimet e fushatës, diapazonin e raportimit financiar, mbylljen e llogarive të fushatës, ndarja e kompetencave për zgjidhjen e kontesteve midis organeve për menaxhimin e zgjedhjeve.

⁶ Qeveria i rishpërnda kuotat për reklamat e paguara politike në mediat transmetuese dhe e ndryshoi kompensimin nga buxheti për reklamimin e paguar politik, që fillimisht ishin brenda kompetencave të Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizale Mediatika (ASHAAM) dhe KSHZ-së, respektivisht.

⁷ Paragrafi 58 i [Listës kontrolluese të sundimit të ligjit të Komisionit të Venedikut të vitit 2017](#) thotë se “[...] ligji, kur është e mundur, duhet të shpallet përpara zbatimit dhe efektet e tij të jenë të parashikueshme: ai gjithashtu duhet të formulohet me saktësi dhe qartësi të mjaftueshme për t’u mundësuar subjekteve juridike ta rregullojnë sjelljen e tyre në përputhje me të”.

përcaktimin e datës, gjë që e pengoi Komisionin të ketë kuorumin e nevojshëm për ta miratuar kalendarin e ri zgjedhor.⁸

Nivelet e ulëta të administratës zgjedhore përfshijnë 80 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK) dhe 3,480 Këshilla Zgjedhore (KZ). Të gjithë anëtarët e KZK-ve dhe tre nga pesë anëtarët e KZ-ve zgjidhen rastësisht nga ana e KSHZ-së nga radhët e nëpunësve shtetërorë dhe komunalë. Baza e vjetëruar e të dhënave e nëpunësve shtetërorë, që është theksuar edhe në raportet e mëparshme të ODIHR-it për zgjedhjet, e ngadalësoi procesin e zëvendësimit të një numri të konsiderueshëm të anëtarëve të komisioneve, fillimisht për shkak të vendimit të qeverisë në mars për të tërhequr rreth 3,200 punonjës shëndetësorë në përgjigje të nevojave të KOVID-19, dhe më pas nga dorëheqja e një numri të ngjashëm shtesë të disa anëtarëve të KZK-ve dhe KZ-ve, të cilët, si arsye, përgjithësisht, i theksuan shqetësimet për shkak të KOVID-19 ose gjendjen shëndetësore. Megjithatë, këto komplikime me sa duket nuk rezultuan me probleme të rëndësishme operative në përgatitjen e zgjedhjeve.

KSHZ-ja gjithashtu formoi 67 Këshilla të posaçme zgjedhore për të zhvilluar votimin e hershëm më 13 korrik për votuesit që janë pozitiv ndaj KOVID-19 dhe ata që janë në vetizolim. KZ-të e posaçme përfshinin tre punonjës shëndetësorë dhe dy përfaqësues të partive politike. KSHZ-ja u përball me sfida të konsiderueshme në formimin e KZ-ve të veçanta. Nga 300 punonjës shëndetësorë të zgjedhur fillimisht për të punuar në këto këshilla, mbi një e treta kërkuan të largohen.

Më 22 qershor, Komisioni për sëmundje infektive miratoi protokollin shëndetësor për zhvillimin e procedurave të ditës së zgjedhjeve. Zhvillimit të dokumentit i paraprinë konsultime me KSHZ-në dhe organizatat e shoqërisë civile, megjithëse sipas disa bashkëbiseduesve këto konsultime ishin të kufizuara dhe rekomandimet nuk u përfshinë në tërësi. Në bazë të protokollit, KSHZ-ja gjithashtu miratoi një udhëzim për procedurat gjatë ditës së votimit, si dhe për regjistrimin dhe votimin e votuesve pozitiv ndaj KOVID-19 që janë në karantinë dhe udhëzime mbrojtëse përkatëse për zyrtarët e zgjedhjeve. Megjithatë, një boshllëk në orarin e trajnimit, i shkaktuar nga pezullimi i zgjedhjeve, krijoi sfida për të siguruar trajnim sistematik për përshtatjet në aspekt shëndetësor të procedurave të ditës së zgjedhjeve; disa trajnime komplimentare ishin të disponueshme. KSHZ-ja gjithashtu rishikoi hapësirat e vendvotimeve për të mundësuar kërkesat për distancë fizike, të parashikuara nga protokollet, megjithëse pranoi se në shumë raste respektimi i tyre nuk ishte i mundur për shkak të mungesës së hapësirave të përshtatshme në dispozicion. Pozitivisht, KSHZ-ja zhvilloi një fushatë gjithëpërfshirëse për edukimin e votuesve, e cila informoi mbi rregullat që janë përshtatur në aspekt shëndetësor për zbatimin e procedurave në ditën e zgjedhjeve, dhe e cila u realizua në disa gjuhë, si në mediat tradicionale, ashtu edhe në ato online.

Qytetarët që janë 18 vjet ose më shumë në ditën e zgjedhjeve, dhe që kanë qëndrim të përhershëm, kishin të drejtën e votës. Atyre që u është marrë e drejta e drejta e votës me vendim gjyqësor në bazë të aftësisë së kufizuar intelektuale ose psikosociale janë të privuar nga e drejta e votës, në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare dhe rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it.⁹ Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, Ministria e Punëve të Brendshme i siguroi KSHZ-së listën e votuesve me letërnjoftime me afat të skaduar midis shpalljes së zgjedhjeve dhe ditës së zgjedhjeve, duke rritur përfshirjen e regjistrit të votuesve. Megjithatë, për të marrë fletëvotim, të gjithë votuesve u kërkohet të paraqisnin një letërnjofim ose pasaportë të vlefshme.¹⁰

⁸ Për shembull, kryetari dhe nënkryetari i KSHZ-së nuk arritën të thërrasin mbledhje për të vendosur një kalendar të ri zgjedhor pas përfundimit të gjendjes së parafundit të jashtëzakonshme, përpara datës së caktuar të zgjedhjeve të 5 korrikut. Rregullorja e punës së KSHZ-së kërkon praninë e presidentit ose nënkryetarit për të pasur kuorum.

⁹ Në bazë të Komisionit Shtetëror Zgjedhor, ky kufizim preku rreth 880 qytetarë.

¹⁰ Pasaportat e skaduara ishin të pranueshme nëse vlefshmëria e tyre kishte mbaruar gjatë periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme.

Sipas ligjit, KSHZ-ja ishte fillimisht përgjegjëse për përpilimin e regjistrit të votuesve në bazë të azhurnimeve të dhëna nga Ministria e Punëve të Brendshme, Zyrën për Udhëheqje me Librat e Gjendjes Civile dhe gjykatat. Para pezullimit të procesit zgjedhor, këqyrja publike e listës së votuesve kishte përfunduar dhe kopjet e listës së votuesve u ishin dorëzuar partive politike. Megjithëse kalendari i ri zgjedhor lejoi azhurimin e regjistrit për t'i larguar personat e vdekur dhe për t'i përfshirë qytetarët që kanë mbushur 18 vjet, nuk u vendos ndonjë periudhë e këqyrjes publike për këtë nëngrup të ri. Më 1 korrik, lista e votuesve u mbyll dhe ajo përfshinte 1.814.263 qytetarë, nga të cilët 83.054 janë paraqitur se banojnë përkohësisht jashtë vendit. Votuesit e tillë regjistroheshin në një listë të veçantë që i dorëzohet të gjithë KZ-ve. Për më tepër, brenda afatit ligjor të 8 korrikut, KSHZ-ja regjistroi 759 votues për votimin e parakohshëm më 13 korrik, të cilët ishin pozitivë ndaj KOVID-19 ose ishin në vetizolim, dhe 10.822 nga 9,499 kërkesa për votim mobil më 14 korrik në shtëpi ose në spitale, institucione të kujdesit jashtë familjes dhe në burgje. Sipas statistikave zyrtare, 989 persona u testuan si pozitivë ndaj KOVID-19 ose hynë në vetizolim pas afatit të 8 korrikut, dhe për këtë arsye nuk kishin të drejtë vote. Organizimi i votimit jashtë vendit bazohet në regjistrimin aktiv që kërkon një prag të barabartë me votat e nevojshme për të fituar një mandat në zgjedhjet e fundit. Procesi i regjistrimit përfundoi në 17 mars, para pezullimit të zgjedhjeve dhe pragu i vendosur për këto zgjedhje në 6.534 votues të regjistruar, nuk u arrit.

Shumë bashkëbisedues të MPVZ-së së ODIHR-it ngritën shqetësime në lidhje me saktësinë e listës së votuesve, përgjithësisht duke pohuar se numri i votuesve të regjistruar tejkalon numrin e qytetarëve me vendbanim të përhershëm, duke e rritur kështu shkallën e abstenimit. Çështjet shumëvjeçare strukturore, si mungesa e standardizimit të të dhënave të adresave dhe harmonizimi në mes institucioneve, që janë identifikuar në raportet e mëparshme të ODIHR-it, mbesin të patrajtuara. Procesi i regjistrimit të votuesve u ndikua në mënyrë plotësuese nga kapaciteti i kufizuar i TI-së i KSHZ-së, dhe për këtë arsye nuk është kryer asnjë kontroll gjithëpërfshirës i cilësisë së regjistrit të votuesve.

Regjistrimi i kandidatëve përfundoi midis 12 dhe 20 marsit, para pezullimit të zgjedhjeve, në një proces gjithëpërfshirës. Për këto zgjedhje, KSHZ-ja lëshoi një aplikacion të ri online për paraqitjen e listave të kandidatëve. Kandidatët mund të emëroheshin nga partitë dhe koalicionet e regjistruara politike, si dhe nga grupet e votuesve, brenda ose jashtë vendit. Kandidatëve të emëruar nga votuesit u duhej të mbledhin të paktën 1000 nënshkrime mbështetëse të votuesve që banojnë në njësinë përkatëse. Për herë të parë dhe në përputhje me një rekomandim të mëparshëm të ODIHR-së, nënshkrimet mbështetëse të votuesve mund të mblidheshin në zyrat e noterëve, si dhe përpara punonjësve të KSHZ-së, në zyrat kompetente rajonale të KSHZ-së. Në fund të periudhës së regjistrimit, asnjë grup i votuesve nuk pati sukses të emërojë listë kandidatësh, pasi asnjë nuk arriti ta mbledhë numrin e kërkuar të nënshkrimeve. Në fund KSHZ-ja regjistroi 12 parti politike dhe 3 koalicione, të cilët paraqitën gjithsej 1.598 kandidatë në 78 lista.¹¹ Të gjitha listat e paraqitura u plotësuan përfaqësimin e nevojshëm prej 40 përqind të secilës gjini, e disa e tejkaluan këtë prag.

Periudha zyrtare e fushatës u hap më 24 qershor dhe përfundoi në mesnatën e 12 korrikut, para ditës së parë të votimit të hershëm. Një seri dekretesh qeveritare përcaktuan masat e sigurisë që duhen zbatuar në takimet publike, duke përfshirë përdorimin e dezinfektuesit të duarve, distancimin fizik dhe veshjen e maskave. Pandemia e KOVID-19 ndryshoi ndjeshëm stilin e fushatës, pasi partitë i zëvendësuan tubimet tradicionale me takime të vogla dhe i kufizuan takimet derë më derë. Përkundër rrethanave, partitë zhvilluan fushatë në mënyrë aktive dhe ishin në gjendje t'i përcillnin mesazhet e tyre. Garuesit u mbështetën në masë të madhe në rrjetet sociale, duke postuar video të takimeve lokale, në të cilat folën kandidatët dhe kryetarët e partive. Reklama të shumta lidhur me fushatën e emetuan në mediat

¹¹ Koalicionet përfshijnë: koalicionin e Lidhjes Social Demokratike të Maqedonisë (LSDM) me BESA-n dhe një numër partish më të vogla, koalicionin e udhëhequr nga Organizata Revolucionare e Brendshme Maqedonase - Partia Demokratike e Unitetit Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) dhe koalicionin e dy partive etnike-shqiptare - Aleanca për Shqiptarët (AA) me Alternativën.

transmetuese dhe në rrjetet sociale, e po ashtu edhe bilbordet ishin mjaft të dukshme. Çështjet kryesore të fushatës përfshinin hyrjen në NATO dhe BE, reformat në drejtësi, ekonominë, mirëqenien sociale dhe shëndetësinë.

Fushata u karakterizua zhvillua me retorikë negative, në vend të debatit thelbësor. Reklamat e Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike e Unitetit Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) përfshinin sulme personale ndaj liderit të Lidhjes Social Demokratike të Maqedonisë (LSDM), ndërsa LSDM-ja paralajmëroi një kthim në "regjimin" e ish kryeministrit të VMRO-DPMNE-së. Shpërndarja e një sërë regjistrimesh paligjshme të liderëve politikë kontribuan edhe më shumë në tonin negativ. Propozimi i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) për kandidat etnik-shqiptar për kryeministër shkaktoi debate të ashpra, si brenda bashkësive etnike ashtu edhe ndërmjet tyre.

Kodi Zgjedhor përmban dispozita të hollësishme për të mbështetur ndarjen e shtetit dhe partisë, parashikon përdorimin e barabartë të hapësirave publike dhe ndalon keqpërdorimin e burimeve shtetërore. Më 18 qershor, KSHZ-ja organizoi nënshkrimin e Kodit për zgjedhje të drejta dhe demokratike nga pjesëmarrësit në zgjedhje. Më 29 qershor, Kryetari i KSHZ-së dhe Ministri i Punëve të Brendshme së bashku u bënë thirrje pjesëmarrësve në zgjedhje që ta respektojnë ligjin, duke paralajmëruar sanksione për presion, detyrim ose blerje të votuesve. MPVZ-ja e ODIHR-it vërejtë raste të izoluara të ministrave nga parti të ndryshme të përzjerjes së funksioneve të tyre shtetërore dhe aktiviteteve politike. Kishte pretendime edhe nga partitë e opozitës për përpjekjet për t'i shfrytëzuar për qëllime politike programet e ndihmave sociale dhe shpërndarjen e ndihmave të lidhura me pandeminë e KOVID-19 dhe pasojat përcjellëse ekonomike. Asnjë provë bindëse për keqpërdorimet e tilla nuk iu paraqit MPVZ-së së ODIHR-it. Partitë politike gjithashtu i raportuan MPVZ-së së ODIHR-it raste të presionit ndaj zyrtarëve publikë, veçanërisht në përfundim të vendit, duke përfshirë edhe policinë. Ditët e fundit para zgjedhjeve ka pasur disa akuza për blerje votash në pjesë të ndryshme të vendit, duke përfshirë njerëzit e rrezikuar në aspekt social, veçanërisht në komunitetin rom dhe prokurorët lokalë hapën hetime.

U vërejtën përpjekje nga disa parti për ta potencuar rolin e grave në fushatat e tyre. Fushata e LSDM-së u përqëndrua në dy kandidatët më të mirë në çdo njësi zgjedhore, një burrë dhe një grua. Gratë kryesuan listën e VMRO-DPMNE-së në dy njësi zgjedhore. Megjithë pozicionimin e grave kandidate në listat zgjedhore, politikanet gra nuk ishin të përfaqësuar në mbulimin mediatik të fushatës. Gratë përbënin 42 përqind të kandidatëve të regjistruar, megjithatë monitorimi i MPVZ i ODIHR-it tregoi se mbulimi mediatik i grave politikane ndryshonte midis 4 dhe 14 përqind të mbulimit të kandidatëve, ndërsa pjesa tjetër iu kushtua pjesëmarrësve meshkuj. Kandidatet gra të cilat u takuan nga MPVZ-ja e ODIHR-it përshkruan mungesën e mbështetjes për gratë e mundshme lidere në strukturat e brendshme partiake.

Fushatat zgjedhore mund të financohen nga donacione monetare dhe kontribute në natyrë nga individë dhe persona juridikë, donacione të partive, anëtarësi dhe kredi bankare të dedikuara për fushatën zgjedhore. Shpenzimet e fushatës janë të kufizuara në rreth 110 denarë (afërsisht 2 EUR) për votues të regjistruar në një njësi (minimum 490,830 Euro në njësinë zgjedhore 3 dhe maksimum 544,930 Euro në njësinë zgjedhore 1), por reklamat e paguara politike në mediat transmetuese, të shtypura dhe në internet financohen direkt nga shteti, përmes një fondi të veçantë i cili administrohet nga KSHZ-ja.¹²

Korniza ligjore për financimin e fushatës kërkon një harmonizim të mëtejshëm për të eliminuar zbrazëtirat dhe mospërputhjet. Në veçanti, dispozitat kundërthënëse kanë të bëjnë me vlerën e lejuar të donacioneve për qëllime të fushatës në llogaritë të fushatës dhe të partive, raportimin mbi kontributet në

¹² Një euro është mesatarisht e barabartë me 61 denarë (MKD).

natyrë, dhe harmonizimin e afateve të raportimit për të siguruar që raportet e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) t'i pasqyrojnë gjetjet e revizionit.¹³

Institucione që kanë për detyrë të bëjnë mbikëqyrjen e fushatës kanë mungesë të kapacitetit për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm si dhe mungesës së burimeve njerëzore, që e dëmtoi kontrollin mbi llogaridhënien dhe transparencën e financimit të fushatës. Për këto zgjedhje, KSHPK-ja ishte në komunikim me shoqërinë civile për të marrë informacione lidhur me dyshimet për shkelje. Për më tepër, Komisioni e forcoi mbikëqyrjen e tij të fushatës me 17 vëzhgues shtesë në terren, të pajisur me ndihmë ndërkombëtare për shkakt të mungesës së fondeve të nevojshme shtetërore, të cilët mblodhën prova mbi aktivitetet e fushatës. Megjithatë, gjetjet e vëzhguesve nuk u bënë publike, që ishte një mundësi e lëshuar për të rritur transparencën.

Dispozitat e paqarta për raportimin e përkohshëm shkaktuan interpretime të ndryshme të diapazonit të tyre. Shumica e pjesëmarrësve të fushatës e vlerësuan kornizën e raportimit të përkohshëm si të tepërt dhe të ngarkuar, duke pasur parasysh se tre raporte të përkohshme duhet të dorëzohen në intervale të shkurtra kohore në tre institucione (KSHZ, KSHPK dhe Entin Shtetëror për Revizion). Detyrimi për publikimin periodik të donacioneve u respektua në mënyrë efektive nga 9 nga 15 garuesit, ndërsa KSHZ-ja nuk i publikoi raportet e përkohshme të garuesve në mënyrë konsekuente, gjë që e zvogëloi transparencën. Raporti i dytë për donacionet u dorëzua nga 10 nga 15 garues, të cilët raportuan kryesisht donacione private dhe pagesa për anëtarësim. Mospërdorimi nga ana e disa pjesëmarrësve e modeleve të përcaktuara të raportimit e bëri të paqartë origjinën e fondeve të transferuara nga llogaritë e partive politike, gjë që e dëmtoi shpalosjen e njëtrajtshme. Me ndryshimet e shkurtit të vitit 2020 në Kodin Zgjedhor u shkurtuan afati për paraqitjen e raporteve përfundimtare të financimit të fushatës nga katër në tre muaj pas zgjedhjeve.¹⁴

Të gjithë bashkëbiseduesit MPVZ-së së ODIHR-it vlerësuan se përmirësimet e konsiderueshme në lirinë e mediave në vitet e fundit nuk u mbështetën me reforma sistematike në sektorin e mediave, siç është sigurimi i neutralitetit politik të *Radiotelevizionit publik të Maqedonisë (RTM)* dhe organit rregullator të mediave. Shumë nga bashkëbiseduesit ngritën shqetësimin se pandemia e KOVID-19 kishte rezultuar në përkeqësim të kushteve tashmë të vështira të punësimit të gazetarëve. Stagnimi i vazhdueshëm në tregun e reklamave i shkaktuar nga pandemia ka rritur më tej varësinë e mediave nga pronarët dhe subvencionet shtetërore.

Kodi Zgjedhor parashikon rregullore të hollësishme për sjelljen e mediave, duke filluar nga shpallja e zgjedhjeve e deri në përfundimin e fushatës. Të gjithë transmetuesit dhe ueb-faqet që i mbulojnë zgjedhjet kërkohet që këtë ta bëjnë këtë në një mënyrë të drejtë, të ekuilibruar dhe të paanshme. Lajmet e *RTM-së* gjatë fushatës i nënshtrohen rregulloreve të përpikta, të cilat u kritikuan nga shumica e bashkëbiseduesve të MPVZ-së së ODIHR-it si të tepërta dhe se e zvogëlojnë pavarësinë editoriale. Megjithëse dy kanalet televizive *RTM-1* dhe *RTM-2* i respektuan këto detyrime, kërkesat rezultuan me mbulim pak më të madh të VMRO-DPMNE-së dhe koalicionit të Aleancës për Shqiptarët (ASH) dhe Alternativës në krahasim me LSDM-në dhe BDI-në. Ndryshimet e shkurtit të vitit 2020 në Kodin Zgjedhor i detyruan më tej transmetuesit kombëtar që të plotësojnë mbulimin e zgjedhjeve me interpretimin në gjuhën e shenjave, por shumica e transmetuesve të monitoruar nga MPVZ-ja i ODIHR-it nuk e përmbushën këtë kërkesë.

¹³ Kodi Zgjedhor gjithashtu përmban dispozita të vjetëruara për kompensimin nga ana e shtetit për shpenzimet e fushatës për garuesit, kandidatët e të cilëve janë zgjedhur.

¹⁴ Paragrafi 200 i Udhëzimeve të ODIHR-it dhe i Komisionit të Venedikut për Rregulloren e Partive Politike rekomandon që "[r]aportet për financimin e fushatës duhet t'u dorëzohen autoriteteve kompetente brenda një periudhe jo më shumë se 30 ditë pas zgjedhjeve".

Debatet e shumta si dhe emisionet me pjesëmarrës u përdorën kryesisht nga garuesit si platforma për kritika personale të ndërsjella.¹⁵ Lajmet e të gjithë transmetuesve kombëtarë të monitoruar nga ana e MPVZ-së së ODIHR-it siguruan një mbulim sipërfaqësor të aktiviteteve të fushatës, të cilat nën hije të akuzave të ndërsjella, si dhe nga pasojat e regjistrimeve të publikuara të liderëve politikë. Raportimi i thelluar analitik ose diskutimet për politikën kryesisht mungonin në mbulimin e fushatës, duke kufizuar mundësinë që votuesit të bëjnë një zgjedhje të informuar midis alternativave të veçanta politike.

Në lajmet kryesore të përqendruara në koalicionet e udhëhequra nga ana e VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së, dy transmetuesit privatë kombëtarë, *Sitel* dhe *Telma*, i siguruan çdonjëri prej tyre pjesë të barabarta prej 31 dhe 22 përqind të mbulimit relevant politik, që ishte kryesisht neutrale në ton. Në dy javët e para të fushatës, *Kanal 5* siguroi pjesë të barabarta të mbulimit mediatik për dy garuesit kryesorë; megjithatë, në javën e fundit të fushatës, mbulimi mediatik i koalicionit të udhëhequr nga LSDM-ja u rrit në krahasim me atë të caktuar për VMRO-DPMNE. Nga ana tjetër, *Alfa TV* e kritikoi ashpër qeverinë dhe LSDM-në në pushtet duke i caktuar atyre 28 dhe 40 përqind, përkatësisht, të mbulimit kryesisht negativ dhe të paanshëm, ndërsa VMRO-DPMNE-ja mori 19 përqind të mbulimit i cili ishte kryesisht neutral në ton. Një trend i ngjashëm është vërejtur edhe në *Alsat*, i cili siguroi rreth 32 përqind të mbulimit kryesisht negativ për BDI-në.

Reklamat e paguara politike subvencionohen plotësisht nga shteti. Korniza ligjore për ndarjen e fondeve për kohën e paguar për reklamë, si dhe shpërndarja e limiteve maksimale për reklama të tilla, u modifikua me një dekret qeveritar të miratuar në 22 qershor, ditën e fundit të gjendjes së jashtëzakonshme. Dispozitat e favorizojnë koalicionin e udhëhequr nga LSDM-ja, VMRO-DPMNE-ja dhe BDI-ja, të cilat kishin të drejtë të përdorin vetëm për qëllime të reklamave të paguara politike rreth 800,000 euro secila, ndërsa dymbëdhjetë garuesit e tjerë kishin të drejtë për vetëm 30,000 EUR secila.¹⁶ Garuesit nuk mund të përdornin fondet e partisë për qëllime të reklamave të paguara politike, që në fakt e bllokoi mundësinë e blerjes së ndonjë reklame shtesë nga dymbëdhjetë listat zgjedhore, pjesa e përbashkët e subvencioneve të cilave ishte dukshëm më e vogël se sa ato të dhëna për secilën nga tre partitë më të mëdha. Reklamat politike në Google AdSense dhe në mediat sociale nuk subvencionohen dhe nuk janë të rregulluara në mënyrë të veçantë. Përderisa partitë politike i përdorën gjerësisht këto metoda fushate, mungesa e transparencës së mjeteve të tilla e bën të pamundur revizionin thelbsëor.

Megjithëse organi rregullator i mediave, Agjencia për Shërbime Audio dhe Audio-vizuale Mediatike (ASHAAM), është i detyruar ta monitorojë praninë e reklamave në mediat transmetuese, nuk është kryer asnjë verifikim apo monitorim i mediave online. Gjatë fushatës, ASHAAM-i zyrtarisht u rikujtoi transmetuesve dy herë ndalesën për të shfaqur fëmijë në materialet promovuese të garuesve, pasi identifikoi reklama, të cilat i shkelën dispozitat.

MPVZ-ja e ODIHR-it vuri në dukje shkelje të shumta të heshtjes zgjedhore në mediat online dhe në një masë më të vogël në mediat tradicionale. Për më tepër, një numër i partive politike vazhduan të reklamonin në internet e poashtu gjatë periudhës së heshtjes paguan reklama negative në mediat sociale. ASHAAM-i reagoi ndaj tre shkeljeve të heshtjes zgjedhore nga mediat transmetuese.

KSHZ-ja hodhi poshtë 42 kundërshtime për zhvillimin e hershëm të fushatës, sepse nuk ishin të mbështetura me faktet, pa i shqyrtuar ato në bazë të meritave. Vendimet ishin formaliste, identike në të gjitha rastet dhe nuk kishin arsytim thelbësor, me vendime formale të cilat merreshin pas skadimit të afateve, gjë që e pengonte mundësinë për mjet efektiv juridik. Për herë të parë, KZK-të kishin

¹⁵ Gjatë periudhës zyrtare të fushatës mes 24 qershorit dhe 12 korrikut, MPVZ-ja e ODIHR-it monitoroi periudhën em shikueshmëri më të madhe (nga ora 18:00 deri 0:00) të shtatë transmetuesve: *RTM-1*, *RTM-2*, *Alfa*, *Alsat*, *Kanal 5*, *Sitel* dhe *Telma*.

¹⁶ Koalicioni i udhëhequr nga LSDM, BDI dhe VMRO-DPMNE kishin të drejtë të blinin deri në tre minuta secila në orën e transmetimit, dymbëdhjetë parti të tjera politike kishin të drejtë në një total prej dy minutash të kombinuara.

kompetencë të shqyrtojnë kundërshtimet për shkelje të të drejtave të votimit në ditën e zgjedhjeve dhe gjatë zgjedhjeve të hershme, dhe vendimet e tyre mund të apeloreshin drejtpërdrejt në Gjykatën Administrative. Për shkak të juridiksionit paralel në ligj, KSHZ-ja shqyrtoi 21 raste të vendosura më parë nga KZK-të, dhe në disa raste kishte mendim të kundërt¹⁷. Në ditën e zgjedhjeve, rreth 40 kundërshtime për të drejtat individuale të votimi u lanë ekskluzivisht për t'u shqyrtuar nga KZK-të. Ekzistimi i mënyrave paralele për zgjidhjen e kundërshtimeve e dëmton qartësinë ligjore dhe është në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.¹⁸ Mekanizmi për të mbrojtur të drejtat e votimit në ditën e zgjedhjeve nuk lejon mjete efektiv juridik.

KSHPK-ja konstatoi shkelje në dy nga pesë kundërshtimet që pretendonin keqpërdorimin e burimeve shtetërore.¹⁹ Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë një ankesë kundër një vendimit për regjistrimin e votuesve në një zyre rajonale të KSHZ-së për shkak të mungesës së provave dhe e konfirmoi si të pabazë ankesën kundër vendimit të KSHPK-së për keqpërdorimin e burimeve administrative. Pandemia e KOVID-19 ndikoi në aftësinë e Gjykatës Administrative për të mbajtur seanca dëgjimore publike dhe për të formuar në kohë kolegji gjyqësorë për zgjidhjen e kontesteve në lidhje me zgjedhjet. Megjithëse institucionet përgjegjëse për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore jo gjithmonë i publikuan vendimet në kohë, shumica bënë përpjekje për të siguruar transparencë duke organizuar konferenca online të mbledhjeve të tyre.

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgim qytetar, partiak dhe ndërkombëtar. Më 19 shkurt, KSHZ-ja miratoi Kodin e sjelljes për vëzhguesit, që është i detyrueshëm për të gjitha grupet e akredituara, i cili u ndryshua më 2 korrik për ta rritur transparencën dhe lirinë e lëvizjes së vëzhguesve. KSHZ-ja akreditoi 2,551 vëzhgues qytetarë dhe 102 vëzhgues ndërkombëtarë brenda afatit kohor. Përfaqësues të disa organizatave të shoqërisë civile dhe të organizatave vëzhguese qytetare, përfshirë MOST-in, CIVIL Qendrën për Liri, dhe Inkluziva, i vëzhguan fazat kryesore të procesit zgjedhor, si dhe disponueshmërinë e tyre për personat me aftësi të kufizuara, gjë që kontribuoi në transparencën e procesit.

MPVZ-ja e ODIHR-it nuk realizoi vëzhgim sistematik dhe gjithëpërfshirës të votimit të hershëm dhe të procedurave të ditës së zgjedhjeve.

Më 15 korrik, në numrin e kufizuar të vendvotimeve të vizituara, votimi në përgjithësi u administrua mirë, me ç'rast KZ-të shfaqën njohuri të mira të procedurave të votimit. U vërejtën disa raste të votuesve me dokumente të reja të identifikimi që nuk ishin përfshirë në listat e votuesve. Çështje të vogla operacionale u raportuan nga administrata zgjedhore.²⁰ Si administrata zgjedhore ashtu edhe votuesit i respektuan kryesisht protokollat shëndetësore, por disa nga ambientet e vizituara nuk kishin hapësirë të mfajtueshme për të mundur distancën e rekomanduar ndërmjet personave. Kur numri i votuesve të lejuar në një vendvotim ishte i barabartë me numrin e kabinave, radhët që pasuan rezultuan me turma në hapësira të përbashkëta, veçanërisht kur disa vendvotime ishin të vendosura në të njëjtin objekt. Në shumicën e vendvotimeve të vizituara personat me aftësi të kufizuara fizike nuk mund të hynë në mënyrë të pavarur.

¹⁷ Rreth 30 ankesa kishin të bënin me të drejtat e votimit të votuesve që kishin të drejtë të votonin në shtëpi apo të atyre në vetizolim, dhe KSHZ-ja konstatoi shkelje në 9 raste

¹⁸ Shih paragrafin II.3.3.c të Kodit të praktikës së mirë për çështjet zgjedhore dhe paragrafin II.3.3.97 të Raportit Shpjegues

¹⁹ Një rast ka të bëjë me përdorimin e një automjeti shtetëror për fushatë nga një ministër, tjetri ka të bëjë me shpërndarjen e paligjshme të fondeve publike gjatë fushatës, bazuar në një dekret qeveritar të detyrueshëm, për të cilin KSHPK-ja i filloi procedurat penale. KSHPK-ja hodhi poshtë tre kundërshtie që pretendonin keqpërdorim të burimeve shtetërore, pasi veprimet dhe vendimet e kontestuara ishin jashtë sferës së kufizimeve të periudhës së fushatës.

²⁰ Për shembull, një gabim shtypi në fletëvotimet në një vendvotim në komunën e Likovës me ndërprerje të votimit, i cili vazhdoi pas qartësimi të problemit.

MPVZ-ja e ODIHR-it pranoi raporte mbi blerjen e votave në rajone të ndryshme të vendit, si në ditët para zgjedhjeve, ashtu edhe në ditën e zgjedhjeve, veçanërisht në mesin e komunitetit rom. MPVZ-ja e ODIHR-it gjithashtu pranoi raporte mbi tension dhe presion mbi votuesit rreth vendvotimeve, veçanërisht në komunat e Kërçovës dhe Sarajit, si dhe një incident të dhunshëm të raportuar në Zajas.

KSHZ raportoi të dhëna të ndara për pjesëmarrjen gjatë gjithë ditës dhe filloi t'i publikojë rezultatet paraprake menjëherë pas mbylljes së vendvotimeve, duke kontribuar në transparencë. Një aplikacion i ri, i bazuar në internet, u prezantua në këto zgjedhje për transmetimin elektronik të të dhënave periodike të pjesëmarrjes, si dhe të rezultateve paraprake. Raportimi i të dhënave të pjesëmarrjes gjatë gjithë ditës u ndikua nga probleme teknike të përkohshme. Natën e zgjedhjeve, kryetari i KSHZ-së raportoi një sulm në internet, i cili e kufizoi aftësinë e KSHZ për t'i prezantuar të dhënat në ueb-faqen e saj. KSHZ-ja u adaptua duke komunikuar të dhënat e rezultateve paraprake përmes transmetimit të drejtpërdrejtë në YouTube.

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.*

INFORMATA PËR MISIONIN DHE MIRËNJOHJE

Shkup – 16 korrik 2020 - Kjo Deklaratë për gjetjet dhe përfundimet paraprake është një vlerësim i bërë për të përcaktuar nëse zgjedhjet përputhen me angazhimet e OSBE-së, detyrimet ndërkombëtare dhe standardet për zgjedhjet demokratike, si dhe me legjislacionin kombëtar.

ODIHR ka miratuar Deklaratën e parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të vitit 2005. Kjo deklaratë e gjetjeve dhe përfundimeve paraprake dorëzohet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, duke përfshirë numërimin, nxjerrjen e rezultateve dhe shpalljen e rezultateve, si dhe trajtimin e ankesave ose kundërshtimeve të mundshme të pas zgjedhjeve. ODIHR do të publikojë një raport gjithëpërfshirës përfundimtar, që përfshin rekomandimet për përmirësime të mundshme, tetë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor.

MPVZ-ja e ODIHR-it, e kryesuar nga Laima Andrikenë, u vendos nga 19 qershori dhe përbëhet nga një ekip kryesor i përbërë nga nëntë ekspertë ndërkombëtarë me seli në Shkup. MPVZ-ja e ODIHR-it nuk ka kryer vëzhgim sistematik dhe gjithëpërfshirës të procedurave të votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve në ditën e zgjedhjeve, në përputhje me metodologjinë e ODIHR për misionet e vlerësimit të zgjedhjeve. Sidoqoftë, anëtarët e misionit vizituan një numër të kufizuar vendvotimesh në ditën e zgjedhjeve.

MPVZ-ja e ODIHR-it dëshiron të falënderojë autoritetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut për ftesën e tyre për të vëzhguar zgjedhjet, dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme për ndihmën e tyre. Ata gjithashtu shprehin vlerësimin e tyre për institucionet e tjera shtetërore, partitë politike, mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin ndërkombëtar rezident për bashkëpunimin e tyre.

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni:

- Laima Andrikenë, Shefja e MPVZ-së së ODIHR-it (+389 2 3222558), në Shkup;
- Katya Andrusz, Zëdhënësjja e ODIHR-it (+48 609 522 266), apo
- Keara Castaldo, Këshilltare për zgjedhjet e ODIHR-it (+48 603 638 999), në Varshavë.

Adresa e MPVZ-së së ODIHR-it:

Nikola Kljusev 6, kati i 4

1000, Shkup

tel: +389–2–3222558, e-mail: office@odih.mk